



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

---

## RAPORT

### I

## MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

*për vizitat në qendrat për azilkërkues*

**Për: Z. Agim Veliu, ministër në detyrë  
Ministra e Punëve të Brendshme**

**Z. Valon Krasniqi, drejtor  
Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim**

**Z. Fitim Zariqi, drejtor  
Qendra për Azilkërkues**

**Z. Samedin Mehmeti, drejtor i përgjithshëm  
Policia e Kosovës**

**Më 23 shkurt 2021**

Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm: MKPT) ka vizituar qendrat për azilkërkues, si në vijim:

1. Qendrën për Azilkërkues në Magurë, më 14 janar 2021.
2. Qendrën për Azilkërkues në Mitrovicë, më 19 janar 2021.
3. Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll, më 25 janar 2021.

#### **Qëllimi i vizitës**

1. Qëllimi i vizitës në qendrat e lartpërmendura për akomodim të azilkërkuesve ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të azilkërkuesve nga autoritetet e Republikës së Kosovës në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm të Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

#### **Përbërja e grupit monitorues**

2. Grupi monitorues përbëhej një këshilltari të lartë juridik për parandalim të torturës dhe një psikologe këshilltare.

#### **Takimet dhe kontaktet e MKPT-së me autoritetet kompetente gjatë dhe pas realizimit të vizitave**

3. Gjatë dhe pas realizimit të vizitave, MKPT-ja u takua me institucionet publike në vijim: Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (tani e tutje: DShAM), Policia e Kosovës (Stacioni Policor Jug, Drejtoria Rajonale e Policisë së Kosovës në Mitrovicë, Stacioni Policor Veri në Prishtinë), Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM), OJQ-në Civil Rights Program Kosovo (CRPK), Agjencinë Shtetërore për Ndihmë Juridike Falas.

#### **Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë realizimit të vizitave**

4. Gjatë vizitës në qendrat për azilkërkues, zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës i ofruan MKPT-së bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat në çdo qendër të cilën e vizitoi, ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe iu mundësua qasja në të gjitha dokumentet e kërkuara, si dhe iu mundësua intervistimi i azilkërkuesve, pa praninë e zyrtarëve policorë dhe as të zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

#### **Qendrat për azilkërkues**

5. Qendrat për azilkërkues menaxhohen nga Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të Rregullores (MPB) nr. 03/2018 për Funksonimin e Qendrës për Azil (tani e tutje: Rregullorja). Sipas nenit 3, pika 1.3, të Rregullores dhe të Ligjit për Azil, qendra për azil definohet si në vijim: “Çdo vend që përdoret për pranimin dhe akomodimin kolektiv të aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare.” Kapaciteti zyrtar në tri objektet (Magurë, Vranidoll, Mitrovicë) për azilkërkues është për 2500 persona. Gjatë vizitave të realizuara, MKPT-ja ka evidentuar se në Qendrën për Azilkërkues në Magurë ishin të vendosur 57 azilkërkues, në Qendrën për Azilkërkues në Mitrovicë ishin 55 azilkërkues, ndërsa në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll ishin 61 të tillë.



6. Neni 14 i Rregullores përcakton se DShAM-ja, në kuadër të MPB-së, vendos në bazë të dokumenteve përkatëse nëse një individ duhet të strehohet në Qendër ose në ndonjë vend tjetër. Qendra konfirmon me anë të fletëpranimit strehimin e azilkërkuesit, i cili i bashkëngjitet dosjes së azilkërkuesit. Më pastaj azilkërkuesi njihet me të drejtat dhe me obligimet, bëhet kontrolli i tij dhe ekzaminimi mjekësor.

### **Të drejtat e azilkërkuesve sipas Ligjit nr. 06/L-026 për Azil dhe sipas Rregullores**

7. Neni 26 i Ligjit nr. 06/L-026 për Azil ka përcaktuar të drejtat e azilkërkuesve, të cilat janë: të qëndrojnë në Republikën e Kosovës, të ketë kushtet themelore të jetesës, kujdesin shëndetësor, ndihmën sociale themelore, ndihmën ligjore pa pagesë, të drejtën e arsimimit për azilkërkuesit fëmijë, të drejtën për lirinë e mendimit dhe të besimit fetar, të drejtën për punësim dhe të drejtën për trajnime profesionale.
8. Ndërsa neni 5, paragrafi 2, i Rregullores shprehimisht përcakton: *“Asnjë aplikues nuk do t’i nënshtrohet torturës, trajtimit jonjerëzor ose përvulës.”* Më tej në nenin 5, paragrafi 1, të Rregullores shprehimisht theksohet: *“Zyrtarit të qendrës duke përfshirë të gjithë ata që punojnë në qendër, iu ndalohej të diskriminojnë ose të fyejnë dinjitetin e aplikuesit, për shkak të racës, besimit fetar, gjinisë, kombësisë, përkatësisë në një grup shoqëror ose bindjeve politike.”* MKPT-ja konsideron se dispozitat në fjalë përbëjnë garanci të duhura procedurale kundër keqtrajtimit, trajtimit poshtëruar dhe çnjëzëzor, si dhe kundër trajtimit diskriminues.

### **Njoftimi me të drejtat e tyre themelore**

9. Neni 11 i Rregullores përcakton se DShAM-ja përpilon një broshurë (në disa gjuhë të huaja) lidhur me të drejtat dhe detyrimet e aplikuesit gjatë procedurës së azilit dhe qëndrimit në qendër. Qendra këtë broshurë e vë në dispozicion të aplikuesve.
10. MKPT-ja ka vërejtur se azilkërkuesit informohen për të drejtat e tyre dhe për procedurat e azilit përmes broshurave dhe dokumenteve të shkruara në gjuhën arabe, angleze, frënge, turke, serbe etj. Përveç kësaj, në korridoret e Qendrës për Azilkërkues në Magurë janë instaluar ekrane të mëdha, ku përmes tyre azilkërkuesit informohen për të drejtat e tyre në gjuhën shqipe, angleze dhe arabe. Po ashtu, në dispozicion të azilkërkuesve dhe të zyrtarëve të MPB-së është edhe përkthyesja për gjuhën shqipe dhe për atë arabe, e angazhuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM).

### **Trajtimi**

11. Gjatë vizitave, MKPT-ja ka realizuar intervista grupore dhe individuale me azilkërkuesit. Intervistat u realizuan në gjuhën angleze, frënge dhe serbe. Ndërsa gjatë vizitës në Qendrën për Azilkërkues në Magurë, MKPT-ja ka intervistuar azilkërkuesit përmes përkthyeses së gjuhës arabe. Të gjithë azilkërkuesit janë shprehur në favor të një trajtimi shumë të mirë dhe human nga zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nga Policia e Kosovës. Përveç kësaj, MKPT-ja ka vërejtur komunikim shumë miqësor dhe interaktiv ndërmjet azilkërkuesve dhe zyrtarëve policorë dhe atyre të Ministrisë së Punëve të Brendshme.



12. Gjatë vizitës në Qendrën për Azilkërkues në Magurë, MKPT-ja ka vërejtur se kushtet e akomodimit janë të një standardi shumë të mirë në kuptim të hapësirës për banim, ndriçimit, pastërtisë dhe ngrohjes. Në përgjithësi, në këtë qendër ishin të akomoduara familjet të cilat kërkuan mbrojtje ndërkombëtare. MKPT-ja, pas vizitave të realizuara, konsideroi se kushtet e akomodimit në Qendrën për Azilkërkues në Mitrovicë dhe në atë të Vranidollit ishin të pranueshme për akomodim të azilkërkuesve, edhe pse nuk janë të standardit të njëjtë si ato në Qendrën për Azilkërkues në Magurë.
13. Gjatë vizitës në Qendrën për Azilkërkues në Mitrovicë, MKPT-ja ka vërejtur se në korridor dhe në oborr të kësaj qendre ishin grumbulluar mbeturinat si pasojë e mungesës së kontejnerit, i cili duhet të vendoset nga kompania publike për menaxhim të mbeturinave. Lidhur me këtë gjendje, MKPT-ja, më 26 janar, ka kontaktuar me kompaninë "Uniteti" në Mitrovicë dhe është njoftuar se kompania dhe institucioni publik kompetent për qendrën për azil duhet të nënshkruajnë marrëveshje, e cila parasheh edhe pagesën për shërbimet e kryera. **Po ashtu, në këtë qendër mungonte një rrobalarëse, e cila do t'ua mundësonte banuesve pastrimin e rrobave të tyre.**
14. Kjo gjendje nuk ishte në pajtim me dispozitat e Ligjit për Azil, i cili shprehimisht përcakton të drejtën e azilkërkuesve për kushte themelore të jetesës. **MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin veprime të menjëhershme për ta mënjanuar këtë mangësi.**
15. Më 28 janar 2021, në Qendrën për Azilkërkues në Mitrovicë shpërtheu zjarri, me ç' rast u shkaktuan dëme të mëdha dhe objekti u bë i pabanueshëm. Azilkërkuesit të cilët u lënduan u dërguan në spitalin rajonal të Mitrovicës, ku edhe morën shërbimin adekuat mjekësor. MKPT-ja u njoftua nga Policia e Kosovës se është duke e hetuar rastin dhe ka intervistuar disa persona. Të gjithë azilkërkuesit u transferuan nga Qendra për Azilkërkues në Mitrovicë për në Qendrën për Azilkërkues në Magurë dhe në atë të Vranidollit.
16. Më 29 janar dhe më 1 shkurt 2021, MKPT-ja vizitoi qendrën për akomodim të azilkërkuesve në Vranidoll dhe atë në Magurë për të mbledhur të dhëna lidhur me azilkërkuesit e transferuar nga Qendra për Azilkërkues në Mitrovicë dhe për të kuptuar se si u trajtuan ata nga Policia e Kosovës, pasi disa nga ata u arrestuan dhe pastaj u liruan. Të gjithë azilkërkuesit e intervistuar pohuan se janë trajtuar shumë mirë nga Policia e Kosovës, që nga çasti i shpërthimit të zjarrit, gjatë intervistimit dhe deri në përfundim të procedurave në polici.
17. Po ashtu, gjatë vizitës në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll, MKPT-ja ka vërejtur se si pasojë e gjendjes së sistemit të kanalizimit, në një pjesë të qendrës kundërmonte erë e rëndë. **MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet ta mënjanojnë këtë mangësi sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që azilkërkuesve t'u garantohen të drejtat themelore, të cilat parashihen me Ligjin për Azil dhe me Rregulloren për menaxhim të qendrës.**
18. MKPT-ja mori ankesa nga azilkërkuesit edhe për mungesën e veshmbathjes së përshtatshme për moshën dhe për gjininë e tyre. Në këtë drejtim, neni 21 i Rregullores shprehimisht përcakton obligimin e autoriteteve kompetente që, në pajtim me Ligjin për Azil, t'i furnizojnë azilkërkuesit me veshmbathje, me ushqim dhe me pako higjienike.



### **Të drejtat fetare**

20. Neni 40 i Rregullores ua garanton azilkërkuesve ushtrimin e të drejtave fetare në qendër. MKPT-ja, gjatë intervistimeve grupore dhe individuale, nuk mori asnjë ankesë nga azilkërkuesit sa i përket së drejtës për t'i ushtruar ritet fetare në qendër në formë individuale apo grupore.

### **E drejta për ndihmë themelore sociale**

21. E drejta për ndihmë themelore sociale u garantohet azilkërkuesve me Ligjin për Azil.<sup>1</sup> Gjatë vizitës në Qendrën për Azilkërkues në Magurë, MKPT-ja ka marrë ankesa nga azilkërkuesit të cilët pretenduan se ende nuk e kishin gëzuar këtë të drejtë. Lidhur me këtë ankesë, zyrtari social i Qendrës e njoftoi MKPT-në se qendra ka aplikuar në organet kompetente dhe shpërndarja e ndihmës sociale do të fillojë nga data 1 shkurt 2021.

### **Ushqimi**

22. Ligji për Azil dhe Rregullorja përcaktojnë të drejtën e azilkërkuesit për ushqim. MKPT-ja u njoftua se azilkërkuesve në Qendër u ofrohen tri shujta me ushqim gjatë ditës, ndërsa azilkërkuesve që vuajnë nga ndonjë sëmundje, siç është diabeti, u sigurohet ushqim bazuar në raportin mjekësor. MKPT-ja ka vërejtur se Qendra ka kuzhinën me të gjitha pajisjet përcjellëse, e cila ishte në gjendje të mirë dhe e pastër dhe azilkërkuesve u ofron ushqim në pajtim me Rregulloren dhe me rekomandimet eventuale të mjekut.

### **Kujdesi shëndetësor**

23. MKPT-ja ka vërejtur se shërbimet mjekësore për të huajt në këtë qendër u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare më e afërt dhe nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Përveç kësaj, MKPT-ja ka vërejtur se një mjek u angazhua nga Jesuit Refugee Service (JRS), i cili qendrat për azilkërkues i furnizonte me barna dhe me materiale të tjera. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa nga azilkërkuesit sa u përket shërbimeve mjekësore, përkundrazi, azilkërkuesit kanë pohuar se shërbimet e nevojshme u jepen në afat sa më të shpejtë.
24. Shërbimet psikologjike ofrohen nga organizata Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT). Meqenëse është rritur numri i azilkërkuesve, u arrit marrëveshje edhe me SOS Fshatrat për të ofruar këshillime psikologjike për azilkërkuesit. Në këtë mënyrë janë rritur kapacitetet për shërbime psikologjike. Psikologu gati çdo ditë është i pranishëm në Qendër dhe u ofron trajtime individuale dhe grupore.

### **Fëmijët**

25. Gjatë vizitës në Qendrën për Azilkërkues në Magurë, aty ishin të akomoduar familjet me fëmijë (rreth 15 fëmijë). Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua se tash për tash në Qendër nuk ka fëmijë të pashoqëruar, e as viktima të identifikuar të dhunës dhe të torturës.
26. Neni 31 i Rregullores përcakton se interesi më i mirë i fëmijëve duhet të merret në konsideratë gjatë zbatimit të Rregullores. Sipas Rregullores, fëmijëve të cilët kanë qenë viktimë e çfarëdo forme të abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit, torturës ose trajtimit

<sup>1</sup> Ligji nr. 06/L-026 për Azil, neni 26, pika 1.4.



shërbime adekuate të trajtimit shëndetësor dhe këshillime të kualifikuara, kur është e nevojshme. Po ashtu, sipas Rregullores, fëmijëve të akomoduar në Qendër do t'u sigurohet qasje në aktivitete zbavitëse dhe në lojëra, në pajtim me moshën e tyre.

27. MKPT-ja ka vërejtur se brenda Qendrës dhe në oborrin e saj ekziston këndi i lojërave për fëmijë, ndërsa fëmijët të cilët i plotësojnë kriteret vijnë mësimin fillor në shkollën fillore afër Qendrës. Po ashtu, gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se JRS-ja ka angazhuar një edukatore për të punuar me fëmijët e azilkërkuesve, e cila është edhe folëse e gjuhës arabe.

#### **Aktivitetet sociale dhe të edukimit**

28. Gjatë vizitës në Qendrën për Azilkërkues në Magurë, MKPT-ja ka vizituar të gjitha hapësirat dhe ka vërejtur se Qendra ka dhomat e aktiviteteve për të rritur, të cilat ishin të pajisura me TV, kishin wifi gjatë gjithë kohës, letra, shah si dhe në një kënd ishte biblioteka me një numër të vogël të librave, dhomën e aktiviteteve për fëmijë të pajisur me lodra dhe të dizajnuar sipas standardeve. Po ashtu, wi-fi është në dispozicion të azilkërkuesve në Qendrën për Azilkërkues në Vrandioll.
29. Gjithashtu edhe oborri i Qendrës për Azilkërkues ka fushën e futbollit dhe hapësirë të mjaftueshme për aktivitete sportive. Në këtë Qendër organizohen kurse të gjuhës shqipe dhe të rrobaqepësisë. **Në përgjithësi, MKPT-ja konsideron se Qendra për Azilkërkues në Magurë i plotëson të gjitha kushtet për aktivitete sociale dhe edukative.**
30. Ndërsa objektet për akomodim të azilkërkuesve në Vrandioll dhe në Mitrovicë nuk kishin hapësira për aktivitete, as TV dhe në përgjithësi nuk zhvillonin asnjë aktivitet në këto dy objekte.

#### **Kontaktet me botën e jashtme**

31. Sipas Rregullores, azilkërkuesve u lejohet të pranojnë vizita në Qendër, të pranojnë pako dhe korrespondencë, ta përdorin telefonin e Qendrës për të komunikuar sipas orarit të caktuar, si dhe të dalin nga Qendra nga ora 07:00 deri në orën 22:00.<sup>2</sup> Po ashtu, Rregullorja përcakton se Komisariati i Lartë i OKB-së për Refugjatët (UNHCR), Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), si dhe organizatat e ndryshme joqeveritare kanë qasje në Qendër. Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e tij kanë qasje dhe komunikim të pakufizuar me aplikuesit e Qendrës.<sup>3</sup>

#### **Masat disiplinore**

32. Neni 51 i Rregullores përcakton masat disiplinore, të cilat mund t'i shqiptohen azilkërkuesit, nëse nuk i zbaton udhëzimet e përcaktuara në këtë Rregullore, të cilat janë: refuzimi i lejes për dalje nga objekti, kufizimi i qasjes në TV apo në internet. Në rast se ndonjë nga azilkërkuesit e vendosur në Qendër manifeston dhunë apo sjellje agresive, me ç' rast rrezikon rendin dhe sigurinë në Qendër, i njëjti mund të vendoset në dhomat e veçanta të Qendrës dhe menjëherë rasti paraqitet te organet kompetente (Policia).
33. Sipas drejtorisë, deri më tani nuk u përdor masa disiplinore e vendosjes në dhoma të veçanta. Përgjegjëse për sigurinë në të gjitha qendrat për azilkërkues përkohësisht është

<sup>2</sup> Rregullorja (MPB) nr. 03/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Azil, nenet 38, 39, 42 dhe 54.

<sup>3</sup> Rregullorja (MPB) nr. 03/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Azil, neni 54.



të cilat ofrojnë sigurim fizik për objektet. Megjithatë, MKPT-ja ka vërejtur se zyrtarët policorë të angazhuar nuk janë të trajnuar për të punuar me këtë kategori.

34. Gjatë takimit me drejtorin e Qendrave ku akomodohen azilkërkuesit, MKPT-ja është njoftuar për dëmtime të shumta dhe keqpërdorime të pronës publike nga azilkërkuesit. Lidhur me këtë, drejtori i Qendrës ka konsideruar se masat e ndërmarra nga organet kompetente nuk janë adekuate për të parandaluar raste të tilla.

#### **Incidentet ndërmjet azilkërkuesve**

35. Lidhur me incidentet e ndodhura ndërmjet azilkërkuesve në qendrat për azilkërkues, MKPT-ja ka pasur takim me zyrtarët kompetentë të Stacionit Policor Jug në Mitrovicë dhe me ata të Stacionit Policor Veri në Prishtinë. Sipas të dhënave nga ky stacion, në Qendrën për Azilkërkues në Mitrovicë, në vitin 2020, Policia e Kosovës ka intervenuar në 15 raste, nga to 7 janë raste të hapura për hetim të mëtejme, ndërsa në vitin 2021 u regjistrua një rast i vdekjes së një azilkërkuesi në këtë qendër dhe një rast i incidentit ndërmjet azilkërkuesve në qendër. Lidhur me rastin e vdekjes në Qendrën për Azil Kërkues, MKPT-ja ka pasur takim me Njësinë e Hetimeve, në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë për Mitrovicë, ku u konfirmua se me urdhër të prokurorit u urdhërua autopsia për ta konstatuar shkakun e vdekjes.
36. Lidhur me incidentet, MKPT ka vërejtur se në regjistrat e Policisë, të cilët qëndrojnë në objektet e azilkërkuesve në Vranidoll dhe Mitrovicë për të kryer detyra të sigurisë, nuk evidentohen incidentet, por aty evidentohen personat të cilët i vizitojnë objektet dhe sa herë është thirrur mjeku nga emergjenca. Për rastet e incidenteve kur intervenon policia nga stacionet më të afërta, evidentohen në ato stacionet policore të zonave ku qëndrojnë azilkërkuesit.
37. MKPT-ja konsideron se njësitë policore të cilat kryejnë detyra të sigurisë në qendrat për azilkërkues duhet të kenë regjistra të veçantë në të cilët do të regjistrohen rastet e incidenteve dhe rastet kur ata detyrohen ta përdorin forcën fizike apo mjetet e tjera për t'i vendosur azilkërkuesit nën kontroll.

#### **Procedura e parashtrimit të ankesave**

38. Çështja e parashtrimit të ankesave është e rregulluar me nenin 43 të Rregullores, i cili ka përcaktuar se azilkërkuesi ka të drejtë t'i parashtrorë ankesë udhëheqësit lidhur me kushtet e pranimit dhe të trajtimit nga zyrtarët e Qendrës. Ankesa më pas dërgohet në DShAM, në kuadër të MPB-së, në afat prej 7 ditësh.
39. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të azilkërkuesve në Qendër është një kuti e ankesave e vendosur nga Qendra. Përveç kësaj, gjatë vizitës, MKPT-ja u ka shpërndarë azilkërkuesve broshura në gjuhën arabe, serbe dhe angleze, të cilat hollësisht sqarojnë mandatin e MKPT-së dhe të Avokatit të Popullit, si dhe mënyrën se si të kontaktojnë me MKPT-në dhe me IAP-në. Po ashtu, Ligji për Azil dhe Rregullorja garantojnë qasje të papenguar për organizatat ndërkombëtare dhe për OJQ-të vendore.

#### **Masat e kufizimit për shkak të COVID-19**

40. Gjatë kësaj periudhe, Qendra për Azil Kërkues, bazuar në vendimet e marra nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga Ministria e Shëndetësisë, ka marrë vendime me qëllim të



gjuhë të tjera.

### **Ndihma juridike falas**

41. Rregullorja përcakton se azilkërkuesit i ofrohet ndihmë juridike falas.<sup>4</sup> MKPT-ja ka vërejtur se azilkërkuesve tash për tash ndihma juridike falas u ofrohet nga organizata joqeveritare Civil Rights Program Kosovo (CRPK) dhe nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.

### **Personeli i qendrave për azilkërkues**

42. Gjatë vizitave, MKPT-ja ka vërejtur se në Qendrën për Azilkërkues në Mitrovicë dhe në qendrën për Azilkërkues në Vranidoll nuk ka personel të përhershëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, por ata shkojnë aty vetëm në raste të caktuara. Kjo gjendje vështirëson mirëfeksionimin e qendrave, por edhe të zyrtarëve të Policisë së Kosovës, të cilët tash për tash kryejnë detyra të sigurisë në këto qendra. Sa i përket personelit në Qendrën për Azilkërkues në Magurë, MKPT-ja ka vërejtur se pavarësisht mungesës së personelit të mjaftueshëm, angazhimi i përkthyeses nga IOM-i dhe i punëtore sociale nga JRS-ja dukshëm kanë kontribuar në lehtësimin e menaxhimit të Qendrës. Lidhur me mungesën e personelit, gjatë takimit me drejtorin e Qendrës për Azilkërkues, më 1 shkurt 2020, MKPT-ja është njoftuar se numri i personelit që do të angazhohet së shpejti do të jetë gjithsej 13 dhe do të jetë i mjaftueshëm për të gjitha qendrat.

43. Më 3 shkurt 2021, MKPT-ja ka pasur takim me drejtorin e DShAM-së, të cilin e njoftoi me të gjeturat gjatë vizitës.

Prandaj, bazuar në të gjeturat gjatë vizitës së Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës, Avokati i Popullit i

## **REKOMANDON**

Ministrisë së Punëve të Brendshme:

- **Të evitohen mangësitë në funksionimin e sistemit të kanalizimit në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll.**
- **Të angazhohet personeli shtesë sipas vlerësimit të nevojës, në të gjitha qendrat për azilkërkues.**

Policisë së Kosovës:


- **Të evidentohen në regjistra të veçantë rastet e incidenteve dhe rastet e përdorimit të forcës fizike apo të mjeteve të tjera nga zyrtarët policorë në qendrat për azilkërkues në kryerje të detyrave të sigurisë.**

<sup>4</sup> Rregullorja (MPB) nr. 03/2018 për Funksionimin e Qendrës për Azil, neni 37.



institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsytet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,



Naim Qelaj

Avokat i Popullit